



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.96/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit Agjensia Kosovare e Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, NSH T..., me seli në Prishtinë NRB: ... dhe me Nr. Fiskal: ..., ndaj debitorit N.T.P “K...” me adresë në rrugën “...” në Prishtinë, me NRB ..., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit N.T.P “K...”, të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.2843/18 të datës 22.10.2018 të Përmbartuesit Privat Isa Gacaferri me seli në Prishtinë, jashtë seancës me datën 14.02.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

PRANOHET si i bazuar prapësimi i debitorit N.T.P “K...” me seli në Prishtinë, ANULOHET urdhri përmbartimor P.nr.2843/18 i datës 22.10.2018 i lejuar nga Përmbartuesi Privat Isa Gacaferri, me seli në Prishtinë, dhe PËRFUNDOHET në tërësi përmbartimi në këtë çështje përmbartimore.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Agjensia Kosovare e Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, NSH T..., ka caktuar urdhërin përmbartimor P.nr.2843/18 të datës 22.10.2018 duke lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm Faturat me Nr. 2018-AP01222 e datës 10.09.2018, Nr. 2018-AP01079 e datës 09.08.2018, Nr. 2018-AP00935 e datës 09.07.2018, Nr. 2018-AP00790 e datës 11.06.2018, Nr. 2018-AP00645 e datës 10.05.2018, Nr.2018-AP00502 e datës 10.04.2018, Nr. 2018 – AP00359 e datës 12.03.2018, Nr. 2018-AP00210 e datës 08.02.2019, Nr. 2018-AP00071 e datës 11.01.2018 me të cilat debitori është detyruar që brenda afatit prej 7 ditësh nga data e dorëzimit të urdhërit, t’ia paguaj kreditorit shumën prej 748.17 euro, me kamatëvpnesë prej 8% në vit duke e llogaritur nga data kur kërkesa është

bërë e arritshme, e deri në pagesën definitive si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përbarimore që do të krijohen prej momentit të dorëzimit të propozimit.

Debitori në prapësimin e paraqitur në kohë sipas ligjit, ka theksuar se po i drejtohem Gjykatës edhe pse e ka informuar Agjensionin e Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit se e ka paraqitur rastin në Gjykatë të njëjtit e kanë inicuar procedurën tek përbaruesi. Tutje ka kërkuar nga Gjykata të ketë mirëkuptim ndaj tije ka shtuar se kërkon nga Gjykata që për ketë çka i ka borxh të ketë mirëkuptim për shkak të kushteve të rënda ekonomike duke u përballë me kredi dhe me përbarues të ndryshëm meqë rast do të bashkëngjit prapë kërkesat që i kishte paraqitur më herët. Më pas ka theksuar se nuk dëshiron ta humbas vendin në pazar pasiqë këtë e ka burim të vetimin të jetesës, nuk ka shtëpi dhe jeton në bashkësi familjare. Në fund ka theksuar me shpresë të merren parasysh kërkesat e tije dhe si të tillë të njëjtën ta aprovoj dhe se për çdo gjë që ka deklaruar mund të dalë dhe t'a argumentoj me fakte.

Lidhur me prapësimin e ushtruar ndaj Urdhërit Përbarimor P.nr.2843/18 të datës 22.10.2018 , kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitivave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i bazuar andaj të njëjtin e aprovoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përbarues ka lejuar përbarimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata vlerëson se në rastin konkret në faturat e lartëcekura, në bazë të cilave është lejuar urdhri për përbarim, nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me nenin 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se*

*në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.*

Gjykata duke u bazuar në të lartëcekurat gjeti se dokumenti - faturat në bazë të të cilave është lejuar propozimi për përmbarim nuk i plotësojnë kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njejta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njejta të jetë pranuar nga debitori. Andaj, duke qenë së debitori nuk e ka pranuar në mënyrë të rregullt faturën, të njëjtat nuk mund të shërbejnë si dokument i besueshëm dhe nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë.

Andaj, duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vlerëson se në rastin konkret dokumenti i besueshëm-faturat mbi të cilat mbështetet propozimi për përmbarim, e mbi bazën e të cilave Përmbaruesi Privat ka lejuar përmbarimin, nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë dhe si rrjedhojë edhe urdhri i lejuar nga ana e Përmbaruesit Privat duhet të anulohet dhe procedura të përfundohet në tërësi.

Gjykata në kuptim të nenit 71 par. 1.1 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti i Përgjithshëm

KPPP.nr.96/22, datë 14.02.2023

Gjyqtar  
Gent Bekeri

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.